



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

Legjislatura VI  
*Sesioni vjeshtor*

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,  
për Persona të Pagjetur dhe Peticione

P-nr.07/2017

Prishtinë, më 20 dhjetor 2017

**PROCESVERBAL**

Në mbledhje morën pjesë: Duda Balje, Lirije Kajtazi, Miljana Nikoliq, Saranda Bogujevci, Mirjeta Kal Iudra, Mexhide Mjaku-Topalli, Luljeta Veselaj-Gutaj, Teuta Haxhiu dhe Albulena Balaj-Halimaj.

Munguan: Frashër Krasniqi dhe Mytahir Haskuka.

Stafi mbështetës i komisionit: Selman Ymeri, koordinator dhe Sulltane Gashi, zyrtare e fushës.

Pjesëmarrës të tjerë: Sami Kurteshi-deputet, Gramoz Paqarada-KDI, Elmina Osmani-RTK-Radio, Valon Dobruna-Kuvendi i Kosovës, Blerina Hoxha-Klinika e Psikiatrisë, Mustafë Prenku-LIVCK dhe Elhame Strumcaku-LIVCK.

Mbledhjen e kryesoi, Duda Balje, kryetare e komisionit.

Anëtarët e komisionit nuk patën vërejtje dhe as propozime të tjera për rendin e ditës, të propozuar nga kryetarja e komisionit, andaj komisioni i zhvilloi punimet me këtë

**Rend dite:**

1. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-31 për Lirinë Fetare në Kosovë;
2. Të ndryshme.

\*\*\*

**1.Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-31 për Lirinë Fetare në Kosovë**

Kryetarja, tha se lidhur me Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Lirinë Fetare në Kosovë, kemi pranuar propozim-amendamente nga Lista Serbe, nga deputeti Ismail Kurteshi dhe nga deputeti Nait Hasani.

Ajo propozoi që komisioni të formojë një grup punues, lidhur me shqyrtimin e këtij projektligji.

Më pas, theksoi se edhe pas formimit të grupit punues, të gjithë anëtarët tjerë të komisionit mund të bashkohen dhe të japin kontributin e tyre.

Komisioni, njëzëri, vendosi që të formojë grupin punues në këtë përbërje:

Duda Balje, kryesuese, Lirije Kajtazi, Miljana Nikoliq, Saranda Bogujevci, Luljeta Veselaj-  
Gutaj dhe Teuta Haxhiu, anëtare.

Më pas, kryetarja konstatoi se sa i përket mbajtjes së dëgjimit publik për këtë projektligj, kjo të mbetet pas fillimit të sesionit pranveror të vitit 2018.

## **2. Të ndryshme**

Kryetarja, tha se me kërkesë të z. Mustafë Prenku, kryetar i Shoqatës së Invalidëve dhe Viktimave Civile të Luftës së Kosovës, kemi caktuar takimin në komision për ditën e sotme.

Teuta Haxhiu, tha se është mirë të thirren të gjitha shoqatat, me sa është në dijeni ajo, janë 4 shoqata që janë të licencuara dhe të ftohen edhe personat përgjegjës të cilët janë të obliguar për licencimin e këtyre shoqatave.

Saranda Bogujevci, tha se meqenëse shoqata e lartpërmendur ka bërë kërkesë për takim në Komisionin Funkcional, është mirë që u kemi dhënë mundësi dhe të vijnë në komision, e pastaj me iniciativën tonë, ne mund t'i ftojme edhe shoqatat tjera.

Mustafë Prenku, tha se jemi këtu për rastet e viktimave të luftës, grave të dhunuara gjatë luftës, kemi një numër të madh prej 500 rasteve, që janë deklaruar në këtë shoqatë, nga viti 2000-2009.

Më pas, ai theksoi se shoqata që ai udhëheqë, kanë aplikuar që të jenë pjesë e Komisionit Qeveritar për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Personave të Dhunës Seksuale gjatë luftës së UÇK-së, sikur shoqatat tjera, por nuk kemi pranuar asnjë përgjigjeje.

Kemi 50 raste që kanë bërë dëshmi në EULEX, shumë raste kanë folur edhe nëpër medie të ndryshme.

Ai tha se kjo shoqatë momentalisht i kanë tri zyre funksionale, në Prishtinë, Fushë-Kosovë dhe në Drenas, të cilat merren me këtë çështje.

Sami Kurteshi, bëri pyetje: në cilat vite janë mbledhur këto dosje, cila është kërkesa e juaj konkrete dhe cili është emri i shoqatës?

Mustafë Prenku, tha se dosjet i kanë mbledhur prej vitit 2000-2009 dhe kërkesa konkrete është që edhe shoqata e tyre të jetë e licencuar, sepse i dimë rastet, i njohim rastet e paraqitura dhe e kanë besimin e plotë tek ne.

Emri i shoqatës është Shoqata e Invalidëve dhe Viktimave Civile të Luftës.

Mexhide Mjaku-Topalli, tha se i intereson të dijë se, si shoqatë, a keni aplikuar për licencim dhe cila është arsyeja që ju kanë refuzuar, me çfarë kriteresh janë pranuar shoqatat tjera dhe a jeni në dijeni se rastet e femrave të dhunuara, të paraqitura në shoqatën tuaj, nëse rastet e njëjta i kanë edhe shoqatat e tjera?

Mustafë Prenku, tha se kanë aplikuar, edhe pse janë refuzuar nuk kanë marrë përgjigje. Sa i përket kriterëve se si janë licencuar shoqatat tjera, tha se nuk i dinë, ndërsa theksoi se rastet e paraqitura të femrave të dhunuara gjatë luftës i kemi vetëm ne si shoqatë.

Saranda Bogujevci, pyeti: dëshmitë që i kanë dhënë te ju, si organizatë, a ekzistojnë ato edhe në EULEX?

Mustafë Prenku, tha se rastet janë edhe në EULEX.

Mexhide Mjaku-Topalli, pasi që Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të UÇK-së, Viktimave të Dhunës Seksuale të Luftës, Viktimave Civile dhe Familjarëve të tyre, do të hyjë në fuqi prej 1 janarit 2018, pyeti se këta persona që i keni ju të regjistruar në shoqatë, a kanë aplikuar në Komisionin Qeveritar?

Mustafë Prenku, tha se nuk kanë aplikuar, kanë aplikuar vetëm në shoqatë.

Teuta Haxhiu, tha se është mirë që të gjithë ata që kanë qenë përgjegjës në kuadër të Qeverisë, për t'i ftuar në Komisionin për të Drejtat e Njeriut dhe të shohim arsyen se pse nuk është licencuar kjo shoqatë, në mënyrë që asnjë person mos të mbetet pa aplikuar.

Duda Balje, kërkoi nga përfaqësuesit e kësaj shoqate që të sjellin dokumentacionin, për të parë formën se si kanë aplikuar, sepse si komision do të mundohemi të ndihmojmë në këtë proces.

Mexhide Mjaku-Topalli, tha se pajtohet që të ftohen të gjitha palët dhe të diskutohet kjo çështje, pse nuk është licencuar kjo shoqatë?

Lirije Kajtazi, na duhet një informatë nga Komisioni Qeveritar, që të njoftohemi se deri ku ka arritur ky proces dhe si ka ecur procedura e licencimit.

Duda Balje, tha se e kemi kuptuar problemin dhe si komision do të mund të kontribuojmë, aq sa kemi mundësi.

Ajo konstatoi se duhet të ftohen në Komisionin për të Drejtat e Njeriut, në muajin janar 2018, kryetarja e Komisionit Qeveritar, znj. Minire Begaj dhe përfaqësues të Zyrës për Qeverisje të Mirë.

Avokatit të Popullit t'i dërgohet një shkresë, lidhur me atë nëse i është kthyer përgjigje për moslicencimin e kësaj shoqate në organin kompetent.

Mexhide Mjaku-Topalli, tha se në janar të ftohen përfaqësuesit e ministrive që kanë marrë rekomandime nga IAP dhe të shohim se sa janë zbatuar ato rekomandime apo pse nuk janë zbatuar.

Saranda Bogujevci, ngriti çështjen që si komision nuk ka pasur ndonjë reagim lidhur me dënimin e aktivistëve të Lëvizjes Vetëvendosje, ku njeri prej tyre, z. Frashër Krasniqi, është edhe anëtar i komisionit. Kemi pasur edhe raste të dhunës në familje, ku dy gra janë vrarë dhe raste të tjera dhe si komision nuk kemi reaguar për shkelje të drejtave të njeriut.

Kryetarja konstatoi se komisioni nuk e vlerëson të arsyeshme të diskutojë apo të reagojë për këtë çështje, sepse nuk mund të interferojmë në çështjet e organeve të drejtësisë.

Mbledhja përfundoi në orën 15:10.

*E përgatiti:*  
*Stafi mbështetës i komisionit.*

Kryetarja e komisionit,

---

Duda Balje